

Parashtruesi i kërkuesës: Blerta Morina, përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika sipas autorizimit të bashkëngjitur (tutje referuar si “**Klienti**”)

Më datë: 04 prill 2018

KËRKESË PËR NDËRRIM TË EMRIT DHE SHËNUESIT TË GJINISË NË DOKUMENTE TË IDENTIFIKIMIT

Arsyetim¹

Me anë të shkresë Klienti kërkon nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë që t'i ndërrohet emri nga “**Blerta**” në “**Bler**” dhe shënuesi i gjinisë nga “**F**” në “**M**” në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe në të gjitha dokumentet e identifikimit, në mënyrë që emri dhe shënuesi i gjinisë të jenë në harmoni me identitetin e tij gjinor. Kërkesa për ndërrimin e emrit paraqitet konform nenit 12 dhe 17 të Ligjit Nr. 02/L-118 për Emrin Personal dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal. Ndërkaq kërkesa për ndërrimin e shënuesit të Gjinisë paraqitet konform Neni 3, paragrafi 1.9 i Ligjit për Barazi Gjinore, nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA FAKTIKE

1. Klienti është shtetas i Republikës së Kosovës i lindur më [REDAKTUAR] Që nga fëmijëria ai ka pasur tendencë të vishet si mashkull dhe të identifikohet me gjininë mashkullore, e jo gjininë femërore të përcaktuar në lindje. Si i rritur, Klienti jeton dhe paraqitet si burrë në të gjitha sferat e jetës: në punë, në qytet, gjatë kohës që e kalon me familje, në shtëpi, gjatë kohës që e kalon me miqtë dhe në të gjitha situatat e rrethanat tjera të jetës së përditshme. Sidoqoftë emri dhe gjinia e shënuar në dokumentet e tij të identifikimit nuk përkon me emrin me të cilin ai prezantohet dhe me gjininë me të cilën ai identifikohet. Kjo e detyron atë që të kalojë nëpër përvoja diskriminuese në jetën e tij të përditshme. Rrjedhimisht, përcaktimi i shënuesit të gjinisë femërore e jo mashkullore, dhe njëherësh emrin “**Blerta**” e jo “**Bler**” në dokumentet e identifikimit paraqesin

¹Përgjatë këtij dokumenti, Klientit do t'i referohemi në gjininë mashkullore nga se kjo është gjinia me të cilën ai identifikohet.

pengesa të cilat nuk ia lejojnë atij integrimin e plotë në shoqëri. Pengesat në fjalë janë të ndryshme dhe paraqiten në jetën e tij të përditshme në raport me institucionet shtetërore, bankat dhe në të gjitha situata tjera çdo herë që i kërkohet paraqitja e dokumentit të identifikimit. Kjo ndodhë pasi që në dokumente figuron gjinia dhe emri femëror, ndërsa ai jeton dhe paraqitet si burrë. Përvojë më e shpeshtë për të është edhe kalimi i pikave kufitare kur i kërkohet të paraqesë dokumentet e identifikimit. Mospërputhja e gjinisë me të cilën ai paraqitet dhe gjinisë e emrit në dokumentet e identifikimit rezultojnë gjithmonë në kontrolla të gjata e marrje në pyetje të pa-nevojshme nga autoritetet shtetërore, gjë që e bën kalimin e pikave kufitare çdo herë një periudhë traumatike për Klientin.

3. Andaj, është esenciale që shënuesi i gjinisë dhe i emri i Klientit në dokumentet e identifikimit të përputhet me gjininë me të cilën ai identifikohet dhe emrin me të cilin ai prezantohet, në mënyrë që ai të arrijë të integrohet plotësisht në shoqëri. Prandaj e paraqesim këtë

kërkesë për ndërrimin e shënuesit të gjinisë dhe të emrit në përputhje të plotë me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi siç është e spjeguar më poshtë.

BAZA JURIDIKE

a) Kërkesa për ndërrimin e emrit

4. Kërkesa për ndërrimin e emrit paraqitet konform nenit 12 dhe 17 të Ligjit Nr. 02/L-118 për Emrin Personal (Ligji për Emrin Personal) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal (UA për Ndërrimin e Emrit). Baza mbi të cilën mbështetet kjo kërkesë është e përcaktuar në nenin 6, paragrafi 1.8 i UA për Ndërrimin e Emrit ku arsyet për ndërrimin e emrit mund të jetë rasti kur **“Emri personal e pengon integrimin e personit në shoqëri.”**

5. Siç u shpjegua edhe më lartë, janë shumë situata në jetën e përditshme në të cilat Klienti ndihet i diskriminuar dhe i përjashtuar nga shoqëria për shkak të mospërputhjes së identitetit të tij gjinor me shënuesin e gjinisë në dokumentet e tij të identifikimit. Andaj emri “Blerta” e pengon integrimin e tij në shoqëri dhe nuk ia mundëson atij të jetojë lirshëm në përputhje me identitetin e tij gjinor. Ndryshimi i emrit të tij nga “Blerta” në “Blert” është esencial për integrimin e tij në shoqëri.

6. Poashtu, kërkesa e Klientit nuk ka pengesa procedurale të cilat do ta pamundësonin ndryshimin e emrit të tij. Asnjë nga pengesat e listuara në nenin 18 të Ligjit për Emrin Personal (tutje referuar si: “UA për Ndërrimin e Emrit Personal”) apo të pengesave të listuara në nenin 5 të

UA për Ndërrimin e Emrit nuk paraqitet në rastin konkret.

Përkatësisht:

- kundër Klientit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale për veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare – kjo dëshmohet nga vërtetimi i të kaluarës kriminale të lëshuar nga policia i bashkëngjitur këtu si **Shtojca Nr. 7**;

- nuk i është shqiptuar asnjë dënim dhe nuk e kemi rastin e vazhdimit të pasojave juridike të dënimit – kjo dëshmohet nga vërtetimi i lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë i bashkëngjitur këtu si **Shtojca Nr.6**

- kërkesa nuk paraqitet për shmangjen e detyrimeve të përcaktuara me ligj – kjo dëshmohet nga paraqitja e vërtetimit nga Administrata Tatimore ku vërtetohet se Klienti nuk ka borxh ndaj shtetit i bashkëngjitur këtu si **Shtojca Nr.8**, si dhe Vërtetimit se nuk ka obligime tatimore ndaj shtetit për tatimin në pronë i bashkëngjitur këtu si **Shtojca Nr.9**.

- emri personal i Klientit nuk është ndërruar në pesë vitet e fundit – fakt i dëshmuar me Vërtetimin nga arkiva mbi historikun e ndryshimit të emrit, bashkëngjitur këtu me **Shtojcën Nr.5** , dhe

- kërkesa nuk ka karakter fytes, imoral, racist dhe është në konformitet të plotë me të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe të vetë Klientit – kjo dëshmohet në bazë të argumentimit të mëposhtëm.

b) Kërkesa për ndërrimin e shënuesit të gjinisë

7. Sipas nenit 3, paragrafi 1.3 të Ligjit për Barazi Gjinore, “gjinia mashkullore” definohe si:

“çdo person që e konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor”.

Pra në këtë definicion nuk hyn përcaktimi i seksit që personi ka pasur në lindje, por me rëndësi është vetëm perceptimi personal i gjinisë apo gjinia të cilën personi e konsideron si të veten. Andaj kërkesa për ndryshimin e shënuesit të gjinisë në dokumente të identifikimit është e bazuar sepse përcaktimi i gjinisë në dokumente duhet të përshtatet me atë gjini me të cilën personi identifikohet.

8. Më tutje, kërkesa për ndërrim të emrit bazohet në faktin se identiteti gjinor sipas ligjeve në fuqi në Kosovë është kategori e mbrojtur ligjore sipas Ligjit për Barazi Gjinore dhe Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Sipas nenit 3, paragrafi 1, pika 9 Ligjit për Barazi Gjinore përcakton definicionin e identitetit gjinor si vijon:

“Identiteti gjinor - kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi, dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje.”

9. Ndërkaq sipas nenit 1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, diskriminimi në bazë të **identitetit gjinor** gëzon mbrojtje ligjore njësoj si bazat tjera të diskriminimit të numëruara në këtë nen. Në anën tjetër, neni 22 i Kushtetutës së Kosovës thekson se "Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike(...)". Tri nga tetë konventat e listuara në nenin 22 të Kushtetutës, përkatësisht (i) **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)**, (ii) **Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike (PDCP)** dhe (iii) **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)** përmbajnë obligime pozitive ndaj shteteve nënshkruese për të mbrojtur të drejtat themelore dhe për të ofruar trajtim të barabartë ndaj të gjithë shtetasve të vet, duke përfshirë këtu edhe personat transgjinor. Duke qenë se të tri konventat janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në Kosovë, të njëjtat obligime pozitive për mbrojtjen dhe

përmbushjen e të drejtave të njeriut i takojnë edhe shtetit të Kosovës.

(i) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe

(ii) Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike

10. Obligimet pozitive të shteteve në raport me njohjen ligjore të identitetit gjinor të personat transgjinor buron pikë së pari nga Neni 6 DUDNJ e garanton të drejtën e njohjes së personit para ligjit dhe përcakton: "Gjithkush ka të drejtë që t'i njihet kudo personaliteti juridik". Pastaj, neni 3 DUDNJ dhe neni 9 PDCP mbron integritetin trupor në kuadër të së drejtës për liri dhe siguri të personit, ndërkaq Neni 12 DUDNJ dhe neni 17 PDCP mbrojnë të drejtën në jetën private.

(iii) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

11. E drejta e respektimit të jetës private dhe familjare është e drejtë e garantuar me nenin 8 KEDNJ. Ky nen përcakton si vijon:

Neni 8

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve".

12. Duke marrë parasysh se sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës, të drejtat dhe liritë themelore interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), obligimet pozitive të shtetit të Kosovës për sigurimin dhe garantimin e të drejtës në jetë private interpretohet sipas vendimeve të kësaj gjykate.

13. Në vitin 1992, në rastin *B. kundër Francës*, GJEDNJ për herë të parë ka vendosur se ka pasur shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare nga neni 8 KEDNJ në rastin kur autoritetet franceze ia kanë refuzuar ndryshimin e gjinisë në regjistrin e gjendjes civile një aplikuese transgjimore (nga mashkull në femër).² GJEDNJ në këtë rast ka vendosur se refuzimi për ndryshimin e gjinisë në regjistrin civil ka shkaktuar që aplikuesja të vendoset në një situatë të përditshme e cila nuk siguron respektin e duhur për jetën e saj private.³

14. Në vitin 2002 është marrë vendimi për rastin *Christine Goodwin kundër Britanisë së Madhe*, i cili njëherësh është edhe vendimi kryesor në lidhje me obligimet pozitive të shtetit për njohjen ligjore të gjinisë sipas identitetit gjinor.⁴ Në këtë vendim GJEDNJ ka krijuar precedentin me të cilin ka vendosur se mosnjohja e gjinisë nga Britania e Madhe me të cilën aplikuesja identifikohet paraqet shkelje të të drejtave të njeriut të mbrojtura me nenin 8 KEDNJ – e drejta në jetën

private

dhe familjare, si dhe nenit 12 KEDNJ që e garanton të drejtën në martesë dhe në krijimin e familjes.⁵ Gjykata vendimin e ka marrë duke u theksuar se nuk ka faktor të rëndësisë së interesit publik të cilat do të peshonin më shumë se interesi individual i aplikueses për t'ia njohur ligjërisht gjininë e ri-caktuar.⁶

15. Kur flasim për mbrojtjen ligjore të personave transgjimor në Kosovë është me rëndësi të përmendet edhe Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit i cili në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus

Curiae) i është drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë në Kosovë. Avokati i Popullit ndër të tjera thekson:

"Për sa i përket kornizës ligjore të Kosovës, pa as të vetmin dyshim mund të thuhet se ajo i mbron të drejtat e garantuara me KEDNJ-në dhe ndalon çfarëdo lloji të diskriminimit të bazuar në orientim seksual **dhe identitet gjinor**. Duke filluar nga korniza ligjore dhe ndërthurja me praktikën e GJEDNJ-së, **nuk mbetet asnjë zbrazëti në legjislacionin ekzistues që kërkon plotësim lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.**"⁷

16. Për shkak të arsytimit dhe argumenteve të paraqitura më sipër, Parashtruesi i Kërkesës

konsideron se kërkesa e tij për ndërrimin e emrit dhe të shënuesit të gjinisë ashtu që të përputhen

B. kundër Francës, nr.1534/87, KEDNJ 1992.

³

³ Ibid, paragrafi 63.

⁴

⁴ *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.28957/95, KEDNJ 2002.

⁵

⁵ Ibid, paragrafi 93, 104, 104.

⁶

⁶ Ibid, paragrafi 93 i Vendimit.

⁷

⁷ Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, *Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në Cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) për Gjykatën Themelore në Prishtinë në lidhje me gjendjen e homofobisë dhe transfobisë*, nr.689/2017, 2 maj 2017 Faqe 75 paragrafi 3.

me identitetin e tij gjinor janë plotësisht të bazuara në legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë. Andaj kërkojmë nga Zyra e Gjendjes Civile që pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, të shtojcave të bashkëngjitura si dhe të thënave të mësipërme të nxjerrë këtë:

VENDIM

I. APROVOHET si plotësisht e bazuar Kërkesa për Ndërrimin e Emrit dhe të Shënuesit të Gjinisë në Dokumente të Identifikimit;

II. NDËRROHET në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe në të gjitha dokumentet e identifikimit emri i parashtruesit të kërkesë nga “**Blerta**” në “**Blert**” në përputhje me identitetin gjinor të parashtruesit të kërkesës dhe

III. NDËRROHET në Regjistrin e Gjendjes Civile dhe në të gjitha dokumentet e identifikimit shënuesi i gjinisë nga “**F**” në “**M**” në përputhje me identitetin gjinor të parashtruesit të kërkesës.

Sipas Autorizimit:

Rina Kika LLM
Avokate
049 355 722
rina@kika-associates.com
Rr. Edith Durham B1 1/11
Prishtinë 10000
Kosovë

LISTA E SHTOJCAVE

Autorizimi i Avokates Rina Kika i nënshkruar më datë 2 prill 2018

Shtojca Nr. 1 Kërkesa e plotësuar sipas Shtojcës 1 të Udhëzimit Administrativ Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal

Shtojca Nr.2 Dokumenti i identifikimit

Shtojca Nr.3 Certifikata e lindjes

Shtojca Nr.4 Ekstrakti nga regjistri qendror i gjendjes civile;

Shtojca Nr.5 Vërtetimin nga arkiva (duke përfshirë historikun e ndryshimeve për emër dhe mbiemër të pasqyruara në regjistrin fizik të lindjes).

Shtojca Nr.6 Vërtetim nga gjykata që nuk është nën hetime të vendbanimit aktual, dhe vërtetimin e vendbanimit të mëparshëm, nëse pala ka bërë ndërrim të vendbanimit si dhe vërtetimin nga vendi i lindjes;

Shtojca Nr.7 Vërtetim nga policia për verifikimin e së kaluarës kriminale;

Shtojca Nr.8 Vërtetim nga administrata tatimore se nuk ka borxh ndaj shtetit;

Shtojca Nr.9 Vërtetim i tatimit në pronë që ka kryer të gjitha obligimet tatimore në pronë.